

## Fakte e Shifra

Misioni | Historiku | Organizimi | Akreditimi | Pro-gramë Studimi | Stafi | Kerkimi Shkencor dhe Inovacioni | Projekte | Polis\_Press | Financat | Bashkëpunimi Ndërkombëtar | Alumni | Jeta Sociale | Instituti Co-Plan | Studio Metro\_Polis

## At a Glance

Mission | History | Organization | Accreditation | Study Programs | Staff | Scientific Research & Innovation | Projects | Polis\_Press | Finances | International Cooperation | Alumni | Social Life | Co-Plan Institute | Metro\_Polis Studio





## PËRMBAJTJE / CONTENT

VIZIONI   VISION.....	03
HISTORIKU   HISTORY .....	04
ORGANIZIMI   ORGANIZATION.....	08
AKREDITIMI   ACCREDITATION.....	10
PROGRAME STUDIMI   STUDY PROGRAMS.....	12
STAFI   STAFF.....	14
KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI SCIENTIFIC RESEARCH AND INNOVATION .....	16
PROJEKTE   PROJECTS .....	18
POLIS_PRESS   POLIS_PRESS .....	20
FINANCAT   FINANCES.....	21
BASHKËPUNIMI / NDËRKOMBËTARIZIMI COOPERATION / INTERNATIONAL.....	22
ALUMNI   ALUMNI.....	24
JETA SOCIALE   SOCIAL LIFE.....	26
CO-PLAN   CO-PLAN.....	28
METRO_POLIS   METRO_POLIS .....	29

## VIZIONI

Vizioni i Universitetit POLIS është të ofrojë ekselencë në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencorë të aftë për të adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij. Për këtë Universiteti POLIS ka këto synime kryesore:

- të pajisë studentët me cilësitet e lidership-it profesional në fushat që mbulon në mënyrë që të ushtronjë influencë për zhvillim pozitiv të vendit dhe rajonit;
- të pajisë studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike sipas standardeve më të larta bashkëkohore duke synuar integrimin e tyre në tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar;
- të kryejë aktivitete studimore, kërkimore, shkencore dhe praktike të lidhura ngushtë me veprimtarinë akademike dhe programet e studimeve që zhvillon;
- t'i shërbejë inovacionit ne fushat ku shtrin veprimtarinë e tij si dhe të ndikojë, në këto fusha, zhvillimet në rajon.
- Universiteti POLIS synon të kthehet në një platformë rajonale dhe pikë reference në Ballkan dhe rajonin e Adriatikut dhe Jonit.

## VISION

The vision of POLIS University is to provide excellence in the education of professionals and scientific researchers capable of addressing the needs of the market and society in areas of interest at home and abroad. POLIS has the following main objectives:

- to provide students with professional leadership qualities in areas covered by it, in order to exert influence for a positive development of the country and the region;
- to provide students with theoretical knowledge and practical skills according to the highest contemporary standards, aiming their integration in the domestic and international labor market;
- to carry out study, research, scientific and practical activities closely related to its respective academic activities and research programs;
- to serve innovation in areas where it extends its activity and influence developments in the region regarding these areas.
- POLIS aims to become a regional platform and reference point in the Balkans and the Adriatic and Ionian region.






## HISTORIKU


Universiteti POLIS është produkt i "erës së ndryshimit" që lindi në fillim të viteve 90-të, një karakteristikë që ai e dëshmon ende sot falë vitalitetit dhe dinamizmit të tij në përbalje me kompleksitetin dhe transformimet e të sotmes. Origjina e U\_POLIS zë fill me themelimin e Co-PLAN, Institutit për Zhvillimin e Habititatit (1995), si një institut joqeveritar kërkimor, por edhe si një lëvizje qytetare që lobon në favor të pjesëmarrjes së publikut në procese transparente të planifikimit e zhvillimit urban dhe qeverisjes së mirë. Në fillim të viteve 2000, Co-Plan themeloi "Qendrën e Trajnimeve". Në 2006, kjo qendër u shndërrua në një Institucion të Arsimit të Lartë, që u quajt fillimi: "POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban". Sot U\_POLIS është një institucion i konsoliduar ne cerek shekulli, por zhvillimet dheritjet e tij sidomos përgjatë dekadës se fundit janë mjaft të rëndësishme. Ato janë shprehur edhe më pas në diagramën e zhvillimit institucional në mënyrë kronologjike, dhe tregojnë se U\_POLIS ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në Shqipëri, me impakt në rajon.

## HISTORY

U\_POLIS was born out of the "new and transformative" spirit of the early 90s, a characteristic that still reflects its own energy and dynamism in the complexity of nowadays. POLIS' origin, Co-PLAN Institute for Habitat Development (1995), is a highly professional research institute and distinguished urban civic movement in Albania, dealing with participatory city planning and good urban/environmental governance. By early 2000, Co-PLAN established its own "Training and Exchange Center" which by 2006 was further extended into the establishment of Higher Education Institution (HEI), namely: POLIS International School of Architecture and Urban Development Policies. Today, POLIS is a consolidated institution whose achievements of the last decades have been relevant and impactful as shown in the timeline below, illustrating the role that POLIS has played and continues to play in the field of higher education and scientific research in Albania and in the region.









## ORGANIZIMI

Universiteti POLIS është një institucion i vetë-financuar dhe me përgjegjësi të forta sociale. Themeluesit janë një grup i spikatur profesionistësh shqiptarë, aktivistë të shoqërisë civile dhe akademikë që synojnë krijimin e "masës kritike" të ekspertizës publike dhe liderisëpit të sipërmarrjes private, të aftë për të shtyrë Shqipërinë dhe rajonin drejt BE-se, dhe trendeve pozitive të zhvillimit global. "Bordi Themelues" ka rol strategjik e mbikqyrës dhe përbëhet nga: S.Dhamo, B.Alijaj dhe D.Shutina.

Liqjërisht, U\_POLIS është Institucion i Arsimit të Lartë (IAL) me statusin "Universitet", i regjistruar dhe akredituar nga autoritet shqiptare dhe euro-piane.

Universiteti drejtobhet nga Rektori dhe Administratori. Pjesë e liderisëpit janë edhe Zv.Rektorët, Dekanët/Zv-dekanët e fakultetave, dhe Drejtuesit e departamenteve e Koordinatoreve e programeve. Universiteti ka në përbërjen e tij edhe "Njësitë mbështetëse" dhe "Strukturat e Pavarura" të cilat garantonjë transparencën, funksionimin dhe qeverisjen e mirë të institucionit. Për programet të cilat ofrohen në bashkëpunim me një institucion tjeter janë ngritur "Borde të përbashkëta menaxhimi" si: Bordi i përbashkët akademik me Universitetin Ferrara Itali; me IHS / Uni-versiteti Erasmus Rotterdam Hollandë; apo me IPAG Business University, Paris Francë, etj.

POLIS ka tri njësi kryesore: tre fakultete (FAD; FPMMU; dhe FKZH - ky i fundit i fokusuar në Kërkim dhe Zhvillim). Çdo Njësi Kryesore përbëhet nga tre Njësi Bazë: dy Departamente dhe një Njësi Kërkimore. Universiteti ka ngritur një njësi ndër-departamentale: "IF - Fabrika e Innovacionit" që bashkon njësitet e treta me natyre kërkimore të çdo fakulteti, të fokusuar tek inovacioni. Në vijim U-POLIS po mbështet nismat e reja për krijimin e qendrave ndër-universitare, një praktikë e re në Shqipëri.

## ORGANIZATION


POLIS University is a privately funded institution with strong social responsibility. The founders are a group of prominent Albanian professionals, activists of civil society, and academics who aim to educate a "critical mass" of experts and leaders of private entrepreneurship who will push Albania and the region towards the EU and global trends. This Founding Board acts as supervisor and strategic apex, and includes: S. Dhamo, B. Aliaj, and D. Shutina.

Legally, U\_POLIS is a higher education institution with the "University" status, registered and accredited by Albanian and European.

University is led by the Rector and the Administrator. Also, part of the leadership is the Deans/Vice Deans of the respective Faculties, the Head of Departments and the Program Coordinators. The university has established "Support units" "Independent Structures" which ensure the well-functioning and efficient governance of the institution. Moreover, as a result of programs offered in collaboration with foreign partner institutions a number of Joint Academic Boards are set up, such as: Joint Academic Board with the University of Ferrara, Italy, with IHS/Erasmus Rotterdam, the Netherlands and with IPAG Business School, Paris, France.

POLIS University has 3 main units: three Faculties (FAD, FUPEM and FRD) the latter focused mainly in research and development activities. Each main unit consists on three base units: two departments and a research center. POLIS has also established an inter-departmental unit: IF – the Innovation Factory that cuts across all three faculties and focuses on innovation. Lately POLIS has been strongly supporting multi / inter -university initiatives that constitute a novelty for the Albanian context.

## Struktura Organizative



Vendim Nr. 1, datë 01.02.2019 (Akreditim Periodik MP  
Politikat e Zhvillimit te Territorit)

Vendim Nr. 1, datë 01.02.2019  
(Akreditim Periodik MP Dizajn Parametrik)

Vendim Nr. 1, datë 01.02.2019  
(Akreditim Periodik BSc Art dhe Dizajn)

Vendim Nr. 1, datë 01.02.2019  
(Akreditim Periodik MSc Dizajn i Aplikuar)

Vendim Nr. 1, datë 01.02.2019 (Akreditim  
Periodik BSc Studime Mjedisore)

Vendim Nr. 1, datë 01.02.2019  
(Akreditim Periodik MSc Menaxhim Mjedisor Urban)

Urdhër Nr. 267, datë 20.05.2016,  
(Akreditim Periodik Institucional)

Urdhër Nr. 267, datë 20.05.2016,  
(Akreditim Periodik Institucional)

Urdhër Nr. 268, datë 20.05.2016,  
(Akreditim Periodik, Arkitekturë dhe  
Dizajn Urban)

Urdhër Nr. 266, datë 20.05.2016, (Akreditim  
Periodik, Planifikim dhe Menaxhim Urban)

Urdhër Nr. 270, datë 20.05.2016,  
(Akreditim, Inxhinieri Ndërtimi)

Urdhër Nr. 269, datë 20.05.2016,  
(Akreditim, MBA)

Urdhër Nr. 242, datë 17.06.2015,  
E içencë Energitike

Urdhër Nr. 187,  
datë 15.05.2015, PhD

Akreditime të përvitshme  
nga ANVUR, Itali nga 2013

Urdhër Nr. 289, datë 11.07.2013, MND

Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013,  
Bache-or, Msc. dhe MP

Urdhër Nr. 227, datë 22.07.2009,  
Akreditim Institucional  
dhe MSc. 5-vjeçare

akreditim nga AESOP (2015)

Vendim Nr. 698, date 11.10.2006,  
dhënia e lejës për hapjen e shkollës

**Akreditime në U\_POLIS**

## AKREDITIMI

Pas themelimit dhe akreditimit të parë institucional, Universiteti POLIS kryen ri-akreditime te rregullta institucionale dhe programore. Ndërkohë që disa pro-grame janë akredituar edhe në nivel European (AESOP / ANVUR / QAA), ose bashkë-organizohen me shkolla partnere të vendeve të BE-së, duke plotësuar standardet e cilësisë së tyre (Itali, Francë, Hollandë). Për më shumë shikoni grafikun në krah. Administrata dhe laboratoret gjithashtu punojne me standardet ISO.

Universiteti POLIS ka shënuar progres të matshëm në të gjitha komponentët: në rritjen dhe konsolidimin institucional, konsolidimin e programeve të studimit, rritjen e numrit të studentëve, rritjen e numrit dhe cilësisë së stafit akademik dhe administrativ, zgjerimin e partnerëve të tij, forcimin e profilit ndërkombëtar, pasurimin e ofertës akademike dhe kerkimore, ruajtjen e fokusit, zgjerimin e portofolit te projekteve, etj. Të gjithë këta komponentë u rikonfirmuan zyrtarisht gjatë procesit të ri-akreditimit periodic/reformë të insti-tucionit në vitin akademik 2016-2017 nga Agjencia Britanike e Akreditimit (QAA), dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences (MAS).

## ACCREDITATION

After the first institutional accreditation, POLIS University has been re-accredited not only as an institution but also for all offered programs. While some joint pro-grams are organized with partners from EU countries and accredited at European level, meeting their quality standards (Italy, France and the Netherlands). For more information see the chart of accreditation. Additionally, the management and the laboratories have also been certified with the ISO standards.

POLIS University has made significant progress in many aspects as; consolidation of institution and academic programs, increasing number of students, increasing number of well prepared academic and administrative staff, strengthening of institution international profile etc. All these components were officially reconfirmed during the academic year 2016-2017 through periodic accreditation process of the institution by the British Quality Assurance Agency (QAA) and the Ministry of Education and Sport (MAS).



## PROGRAME STUDIMI


POLIS synon të sjellë një frysme të re në profesionet e arteve e dizjanit, shkencave të territorit e qytetit, inxhinierise e teknologjise, dhe qeverisjes se mire. Universiteti ka dizenjuar një menu të pasur, por të fokusuar prej 18 programesh dhe specialitetesh akademike, në 4 nivele të spektrit edukues (profesional pas-sekondar, bachelor, master, pas-universitar dhe doktoral). Këto programe ofrohen kryesisht me kohe të plotë, por edhe me kohë të zgjatur (part-time), duke iu përshtatur nevojave të shoqërisë.

Programet "Master Profesional" ofrohen në bashkëpunim me "IHS/Erasmus University" Rotterdam Hollandë, dhe me "IPAG Business School" Paris Francë. Programet "Master Ekzekutiv" dhe "Programi Doktoral" ofrohen si programe ndërkontinentare, respektivisht si "Diplomë e Përbashkët" dhe "Diplomë e Dyfishtë" me Universitetin Ferrara Itali, si dhe me një koalicion shkollash europiane te afiliuara si: Politekniku i Bratislaves Slovaki, U-Minho Portugali, U-Portsmouth UK, U-Malta, U-Pécs Hungary, etc.




## STUDY PROGRAMS

U\_POLIS aims to bring a new approach and philosophy towards the disciplines of design, architecture, territory and city sciences, engineering and technology. POLIS University provides a rich, but focused range of 18 academic programs and academic profiles in 4 levels of study (professional, bachelor, master and postgraduate) including doctorate (PhD) studies. These programs are delivered as full time or extended time programs, catering for the needs of working professional to further improve their qualifications. The "Professional Masters Programs" are offered in collaboration with "IHS Rotterdam/Erasmus University", the Netherlands and with "IPAG Business School", Paris, France. While the Executive Master and the PhD program are offered respectively as a joint and a double degree diploma in collaboration with University of Ferrara, Italy, supported by a coalition of affiliated partners such as Slovak Technical University, U-Minho, Portugal, U-Portsmouth UK, U-Malta, U-Pécs Hungary, etc.



# Nivelet e Studimit / Level of Studies



## OUR STUDY PROGRAMS

VET-5 (post-secondary programs)	BACHELOR	MASTER	Integrated Master programs	Executive Master and PhD	LLL courses
Energy Efficiency	Art and Design	Applied Design	Architecture and Urban Design	Executive Master in “Restoration, Renovation and Valorization of Cultural Heritage”	Energy Audit
IT Networks	Civil Engineering	Civil Engineering	Planning and Urban Management	(joint degree with University of Ferrara, Italy)	Real Estate
	Computer Science	Computer Science			Agricultural Land Assessment
	Environmental Studies	Environmental Management MBA Digital Architecture Planning and GIS		PhD in “Architecture and Urban Planning” (double degree with University of Ferrara, Italy)	

**Programme Akademike në U\_POLIS**


## STAFI

Stafi është “kapitali me thelbësor” për një institucion akademik, prandaj, rekrutimi dhe zhvillimi i burimeve njerezore ka rëndësi të jashtëza-konshme për suksesin e Universitetit POLIS. Për sa i përket aspektit të personelit akademik-kërkimor U\_POLIS është përpjekur të tërheqë staf sa më të kualifikuar, me përvojë e me grada dhe tituj, të përkushtuar në procesin e mësimdhënies; dhe me edukim e eksperience akademike e profesionale, qoftë nga Shqipëria, por edhe vende të tjera si: Itali, USA, Francë, Hollandë, Austri, UK, Greqi, etj. Në U\_POLIS janë angazhuar rrëth 200 staf akademik (brendshem dhe jashtem) nga 22 vende të botës.



## STAFF

The “human capital” is the most important element of an education institution. Therefore, personnel recruitment and development have been always highly significant for success of POLIS University. POLIS University has a strong presence of a considerable number of academic staff with academic titles, dedicated to the teaching process with not only academic experience but also professional from Albania as well as other countries like France, Holland, Italy, USA etc. In POLIS University is engaged staff from 22 different countries.



## KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI

Në mbështetje të misionit të tij për të krijuar, zhvilluar, përcjellë dhe mbrojtur dijen, teknologjinë dhe mendimin për zhvillim dhe inovacion, gjatë pesë viteve të ardhshme (2021-2026), U\_POLIS parashikon të jetë një institucion me reputacion ndërkombetar për kërkim novator që pret përmes kufijve disiplinorë, të matur sipas standardeve kombëtare e ndërkombeatore. Kërkusit e POLIS, të organizuar në grupe me interes të përbashkët kërkimor, do të intensifikojnë angazhimin e tyre në partneritet lokale, rajonale e botërore për të prodhuar kërkim teorik e aplikativ që i përgjigjet sfidave të mëdha sociale, ekonomike e mjesdisore të rendësishëm kombëtare e ndërkombeatore. Disa nga qëndrat tona kërkimore janë:

- OMB, Observatory of Mediterranean Basin – Qendër ekselencë e UNECE për vendbanimet e qëndrueshme dhe reziliente
- POLIS Makerspace – laboratori fabrikimi dixhital, protipizimi dhe printimi 3D
- Energy Lab – eficiencë dhe audit energjistik
- Sust-Lab – laboratori testimi (i ujit, ajrit e tokës)
- Galeria e Artit “Gëzim Qëndro”
- Polis-Press – njësia e botimeve
- Periudikët shkencorë ndërkombetarë - “Forum A+P” and “WBInTG”
- Bashkë-themelues i Tirana Inc. - program multi-universitar inkubimi për startups (në koalicion me 4 universitete të tjera shqiptare mbështetur nga EU4Innovation and Preneurz. Amsterdam)
- Partnerë të afiliuar:
- Co-Plan- Institute for habitat Development
- Metro-POLIS - Studio projektimi

Objektivat tona strategjike të kërkimit janë:

- Ngritja dhe operacionalizimi i shtyllave kërkimore.
- Nxitja e kulturës kërkimore të grupeve.
- Lidhja e kërkimit shkencor me projekte finançuara nga jashtë.
- Krijimi i produkteve moderne të kërkimit.
- Mbajtja e një ekilibrit të mirë midis rezultateve të kërkimit në nivel lokal dhe ndërkombetar.
- Krijimi dhe mbështetja e një imazhi kërkimor që komunikon kulturën tonë kërkimore.

## SCIENTIFIC RESEARCH AND INNOVATION


In pursuit of its mission to create, develop, transmit and protect knowledge, technology and leadership for development and innovation, in the next five years (2021-2026) U\_POLIS envisages itself becoming an institution enjoying international reputation for innovative research cutting across disciplinary boundaries, measured after national and international standards. POLIS researchers, organized in groups working to accomplish joint ends, will intensify their engagement in collaborations and partnerships locally, regionally and globally to produce theoretical and applied research that addresses major social, economic and environmental challenges of national and international importance. Some of our research units are:

- OMB, Observatory of Mediterranean Basin – UNECE Center of Excellence in sustainable and resilient settlements
- POLIS Makerspace – A Digital fabrication, prototyping and 3D printing lab
- Energy Lab – energy efficiency and energy auditing
- Sust-Lab – environmental tests (primarily water, but also soil and air)
- Art Gallery “Gëzim Qëndro”
- Polis-Press – the publishing unit
- International journals - “Forum A+P” and “WBInTG”
- Co-founder of Tirana Inc. a multi-university incubation program for startups (in coalition 4 other Albanian Universities supported by EU4Innovation and Preneurz. Amsterdam)
- Affiliated partners
- Co-Plan- Institute for habitat Development (research in city sciences, territory and good governance)
- Metro-POLIS Studio Ltd – an architecture design practice

Our strategic research objectives are:

- Establishment and operationalization of research pillars.
- Fostering group research culture.
- Linking scientific research with externally funded projects.
- Producing state-of-the-art research outputs.
- Maintaining a sound balance between locally and internationally-oriented research outcomes.
- Creating and sustaining a research image communicating our research culture.


## “ORGANIZATION UMBRELLA” RESEARCH, DEVELOPMENT AND INNOVATION



## PROJEKTE

Kërkimi shkencor është pjesë integrale dhe e domosdoshme e arsimit të lartë. Universiteti POLIS është i ndërgjegjshëm që mund të bëjë edhe më shumë në këtë drejtim, edhe pse jemi krenare me faktin që kërkimi shkencor dhe praktik ka qenë pjesë e veprimitarës institucionale që në gjenezën e tij fale prezences së Co-PLAN dhe Metro-POLIS. Kjo përparsësi e padiskutueshme mundësoi një pervoje me gamë të gjerë projektesh kërkimi shkencor e të aplikuar bi-lateral dhe multi-lateral të mbeshtetur nga donatore dhe politika ndërkombe të zhvillimit, si: BE, Banka Botërore, UNDP, USAID, etj.

Si rrjedhojë procesi në U\_POLIS ka qenë një tranzicion i natyrshëm nga kërkimi shkencor e praktika profesionale drejt mësimdhënësive. Kjo është realizuar gradualisht e pa sforço, dhe në mënyrë më të qëndrueshme se përvojat anasjelltas, që janë më tipike për institucionet e tjera akademike shqiptare. Megjithatë krahas experiençës së Co-PLAN dhe asaj të Universitetit POLIS, kërkimi shkencor dhe ai i aplikuar mbeten sfida më e rëndësishme me të cilin përballet institucioni sot dhe në të ardhmen, aq më tepër tashmë që ai përpinqet të operojë në nivel rajonal dhe europian për të sjellë një impakt të prekshëm në favor të zhvillimit.



## PROJECTS

Scientific research is an integral and essential part of higher education and POLIS University is aware that it can do more in this field. However, we are satisfied that since the establishment of the institution, scientific research has been a part of its institutional activity as a result of presence and experience of Co-PLAN and Metro-POLIS. This enabled indisputable advantages of experience with a wide range of scientific applied research projects bilateral and multilateral supported from donators and international development policies, such as EU, World Bank, UNDP, USAID, etc.

Consequently, the process has been a transition from research to teaching, which is obviously more natural and stable than vice versa. This process is done gradually so is more sustainable than conversely experiences that are more typical for other academic institutions in Albania.


However, along the experience of Co-PLAN and POLIS University, scientific and applied research remain the most important challenges that the institution faces, which is already trying to operate at regional and European level, in order to bring a tangible impact through the research it develops.





## POLIS\_Press

"Qendra Burimore e Informacionit" kujdeset për disa kategori publikimesh, si: tekstet e brendshme mësimore, monografite shkencore, periodikët shkencorë, botimet publike, etj. Publikimet perfshijnë: revistat shkencore "Forum A+P" dhe "TGin WB", revistat "Habitat" dhe "Multimedia-Art-Dizajn", etj. Nderkohe "Biblio\_POLIS" perbehet nga fondi fizik me mbi 10,000 volume ne fushat e interesit te POLIS, si dhe "Bibliotekat Online" JSTOR dhe EBSCO.



## POLIS\_Press

The Resource and Information Centre takes care of several categories of publications, such as: textbooks, scientific monographs, scientific periodicals, etc. The publications include: scientific journals "Forum A+P" and "TGin WB", "Habitat" and "Multimedia-Art-Design" magazines , etc. The "Biblio\_POLIS" consists of the physical fund with over 10,000 volumes in the areas of interest of POLIS, as well as the "Online Libraries" JSTOR and EBSCO.

## FINANCAT


Burimi i financimit të U\_POLIS vjen kryesisht nga kontributi i themeluesve, tarifat e studimeve, të ardhurat nga projektet kërkimore dhe shërbimet e konsulencës, si dhe nga kontributi të palëve të treta, donacione, të ardhura të vazhdueshme nga tarifat e studentëve, përjashtimi nga TVSH ose financime publike për kërkimin në raste specifike. Diversifikimi i shërbimeve dhe burimeve të financimit është një nga pikat e fortë të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë institucionale të U\_POLIS.

Pas gati 2 dekada investimesh U\_POLIS ka ndërtuar tashmë kapacitetet dhe një profil unik në treg, duke rritur vazhdimisht vizibilitetin përmes pjesëmarries aktive në gara, konkurse, projekte kombëtare e ndërkombëtare. Tashmë institucioni nuk varet vetëm nga burimet e mësimdhënies dhe tarifat studentore, por ka diversifikuar burimet dhe produktet. Turnover-i vjetor i POLIS dhe njesive autonome si Co-PLAN dhe Metro-POLIS shkon ne rreth 4-4.5 milion euro ne vit.

## FINANCES

The financial sources of U\_POLIS consist mainly in founders' contribution, tuition fees, income from research projects and consulting services, as well as from third-party contributions, donations, VAT exemption or public funding for research in specific cases. Diversification of funding services and resources is one of the strengths of the development and institutional sustainability of U\_POLIS.

After nearly 2 decades of investment U\_POLIS has already built up capabilities and a unique profile in the market, constantly increasing visibility through active participation in calls, competitions, national and international projects. Already the institution depends not only on teaching resources and student fees, but has diversified its funds. The annual turnover of POLIS and autonomous units such as Co-PLAN and Metro-POLIS amounts to about Euro 4-4.5M per year.



## BASHKËPUNIMI / NDËRKOMBËTARIZIMI

Universiteti POLIS është një institucion i karakterizuar nga një dimensioni i spikatur rajonal dhe ndërkombëtar, gjë që reflektohet në programet e studimit, përbërjen e stafit akademik, studentët, por dhe në shkëmbimet dhe projektet intensive e të larmishme me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë; si në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore e didaktike ashtu dhe në mobilitetin e lartë mes stafeve akademiko-kërkimore dhe studentëve.

U\_POLIS është universiteti i parë shqiptar nënshkrues zyrtar i "Observatorit të Kartës së Bolonjës - Magna Charta Universitatum" në Itali; dhe është anëtar aktiv i shoqatave "CEEPUS - Programi i Shkëmbimit të Europës Qendrore për Studime Universitare"; "CEEMAN - Shoqata për Zhvillim Menaxhim të Evropës Qendrore dhe Lindore"; "AESOP - Shoqata e Shkollave Europiane të Planifikimit"; "AEEA/EAAE - Shoqata Europiane për Arsim në Arkitekturë"; "ECLAS - Këshilli European i Shkollave të Arkitekturës së Peisazhit"; "AUA - Unioni Shqiptar i Arkitekteve Urbanisteve dhe Planifikuesve Urbane", EUCEET, ISOCARP, EACSS, etj.

U\_POLIS ka një rrjet të zgjeruar të partnerëve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtarë. Partnerët dhe llojet e bashkëpunimit varojnë nga partneritetet afatgjata strategjike, me të cilët U\_POLIS ofron programe akademike të përbashkëta, si dhe projekte kërkimore të përbashkëta; deri në partnerë te natyres 'ad-hoc' të përzgjedhur për veprimtaritë caktuara si, binalet, workshop-et e përbashkëta, veprimtaritë kërkimore të përbashkëta dhe skema për mobilizim të personelit dhe të studentëve.

## COOPERATION / INTERNATIONAL

POLIS University is an institution characterized by a international dimension, which is reflected in the programs of study, the composition of the academic staff and students from different nationalities. Also exchanges programs and high mobility between academic staff and students with various international partners in the framework of joint research and activities is another important point of this process.

POLIS University is the first Albanian university who officially signed the Bologna Charter otherwise known as "Magna Charta Universitatum" in Italy; is active member of following associations: "CEEPUS - Central European Exchange Programme for University Studies"; "CEEMAN – Central and Eastern European Management Development Association"; "AESOP – Association of European Schools of Planning"; "AEEA/EAAE – European Association for Architectural Education"; "ECLAS – European Council of Landscape Architecture Schools"; "AUA - Albanian Union of Architects and Urban Planners", EUCEET, ISOCARP, EACSS, etc.

POLIS University has a wide network of national and international partners. Partners and type of cooperation between them consist on, firstly in long-term strategic partnership, with whom POLIS University offers joint degree programs and research projects, secondly in ad-hoc partners selected for certain activities such as joint workshops, common research activities and mobilization schemes of personnel and students.







## ALUMNI

Shoqata e ish-studentëve ALUMNI, ushtron veprimtarinë e saj në koordinim të ngushtë me organet drejtuese të Universitetit POLIS dhe ka në fokus mbarëvajtjen profesionale dhe jetën sociale komunitare të individëve që kanë kryer studimet në U\_POLIS. Nëpërmjet takimeve dhe aktiviteteve, ajo ndihmon në transmetimin e ideve, nismave, inovacionit, bashkëpunimeve midis njëri-tjetrit të cilat janë më se të nevojshme pas proçesit të diplomimit dhe sidomos përballjen me tregun e punës. U\_POLIS mendon se njohuritë dhe aftësítë e fituara gjatë studimeve do të arrijnë të bëjnë dallimin e vertetë të diplomuarve të tij në tregun e punës, përkundrejt traditës së vjetër të studentit 'teorik' me nota 'të shkëlqyera'.

Duke marrë në konsideratë recensionin ekonomik global e rajonal, si dhe përqindjen e lartë të papunësisë në vend, ne mendojmë se kjo është dukshëm një provë e fortë e cilësisë së programeve respektive të studimit, dhe e reputacionit të institucionit që i ofron ato. Punësimi i diplomantëve është ndoshta treguesi më domethënës në lidhje me përqindjen e suksesit të rezultateve të synuara të formimit për çdo program të studimeve, ndaj ky është një konfirmim i rëndësishëm nga tregu i punës. Arsyet kryesore të identifikuara nga tregu në lidhje me punësimin janë: serioziteti, angazhimi, njohuritë bashkëkohore, dhe sistematika. Tashmë ka edhe mijëft raste që ish-studentet tanë po promovohen në pozicione karriere në ndermarrje private, institucionale publike, apo edhe në ato me karakter vendim-marrës dhe politikë-bërës.



## ALUMNI

The Association of Former Students, ALUMNI exercises its activity in close coordination to the governing organs of POLIS University and focuses on the professional welfare of the individuals who have completed their studies at the University. Through meetings and activities, ALUMNI help in the transmission of ideas, initiatives, innovation and cooperation between each other which are very important after the graduation process especially dealing with the labor market. POLIS University retains that the knowledge and skills acquired during the studies will be able to differentiate its graduates in the labor market as opposed to the "excellent" grades.

Considering the unemployment rate of the country and recently in Europe, this is clearly strong evidence of the quality of the study programs and the reputation of the institution delivering them. The employability of the graduates is probably the most significative indicator regarding the success rate of the intended learning outcomes for each study programs, so this is an important confirmation from the labor market. The main reasons identified by the market of high rate employment are: seriousness, commitment, contemporary knowledge and systematic qualities of graduated students. Already there are many cases that alumni are engaged in various career position in private institutions, public institutions some of them as policy makers or decision makers.







## JETA SOCIALE

Komuniteti POLIS ka një rrjetëzim dhe jetë të pasur sociale, artistike dhe intelektuale. Në POLIS funksionojne "Klubet" e pavarura por që ndajnë së bashku: vlerat, misionin dhe filozofinë e përbashkët të U\_POLIS. Disa nga klubet sociale më të spikatura janë:

"*Arch\_House*" - një hapësirë alternative për takime sociale periodike dhe ekspozim e diskutim të çeshtjeve të ndryshme me interes për studentet, stafin dhe partnerët;

"*Googoats*" dhe "*El Peor*" - klube alternative studentore, ku zakonisht komuniteti POLIS takohet me rrethe të tjera profesionale në Tiranë apo vizitorë të huaj. Në këto ambiente shpesh punohet për projekte akademike dhe konkrete, në kushtet e një atmosferë sa më informale dhe të lirshme;

"*Klubi i Sportit: Get Fit & Fun*" - organizon në mënyrë periodike evenete sportive, si aerobi, volejball, basketball, si dhe kampionatin e futbollit të U\_POLIS;

Klubi "*Walking The City*" - që stimulon lëvizjet mjedisore, kulturore, turistike dhe sportive të këmbësor-izimit dhe përdorimit të bicikletave në qytet, duke organizuar periodikisht ecje të lira në itenerare alternative, jashtë korridoreve të motorizuara të qyteteve, duke i kontribuar njoftes dhe sensibilizimit për një qytet alternativ, që shumë nga ne e kemi pranë por nuk e njoftim mirë.

U\_POLIS ka një komunitet aktiv me student. Si rrjedhojë është themeluar Senati Studentor pér të krijuar një urë komunikimi ndërmjet studentëve dhe Universitetit, shoqërisë dhe tregut të punës gjatë studimeve. Ata organizojnë zgjedhje të lira, marrin pjesë në takimet e Senatit, ndajnë informacione mbi punësimin, monitorojnë e sigurojnë informacion pér Rektoratin dhe Senatin Akademik.

## SOCIAL LIFE

The POLIS network has a rich network and a wealthy social, artistic, and intellectual life. The Clubs in POLIS function independently but share their values, mission and the common philosophy of POLIS. Some of the most prominent social clubs are:

“Arch\_House” – an alternative space for periodic social meetings and discussion of various issues of interest for the students, staff, and partners;

“Googoats” and “El Peor” – an alternative student club equipped with ‘internet café’ services and in which the POLIS community meets with other professionals in Tirana or with foreign visitors. These spaces are usually used for work on academic and concrete projects in a casual and comfortable atmosphere;

“Culturoteque POLIS” – is an ongoing POLIS project which will reflect the culture, style, and taste of the “POLIS model” in Tirana;

The “Sport” club: Get Fit & Fun” – periodically organizes sporting activities like aerobics, volleyball, basketball, and also the U\_POLIS soccer championship;

The “Walking the City” club – stimulates the environmental, cultural, touristic, and athletic movement of pedestrians and bicycles in the city by periodically organizing alternative-itinerary walks outside of the cities' motorized corridors, thus contributing to the understanding of and awareness toward an alternative city, which is close to us but still, we are not fully aware of it.

POLIS has quite an active community of students. Consequently is established Student Council, to represent them and bridge relations with university, society and market, during studies. They organize free elections, participate in Senate meetings. Share employment info, monitor career development, initiate social and sport events, and provide useful feedback to the Rectorate and Academic Senate.



## Co-PLAN

"Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit" - është praktikisht origjina dhe inspirimi i themelimit dhe konsolidimit të Universitetit POLIS sidomos ne fushat e planifikimit dhe zhvillimit urban. Co-PLAN është një nga NGO-të lidere në Shqipëri e rajon, që ka luajtur një rol kyç në përvojat e planifikimit alternativ dhe me pjesëmarrje gjithpërshirëse. Përvuja e Co-PLAN u konsolidua nga projektit me bazë komunitare, në projekte asistencë për qeverisjen vendore dhe qëndrore, në bashkëpunim me donatorë e partner lokale dhe ndërkombëtarë, përfshi: Banken Botërore, UNDP, USAID, EU, FAO, ADA, SOROS, SCP, MATRA, NUFFIC etj., duke luajtur rolin e një ure lidhëse që kontribuon për ngritjen e kapaciteteve të qeverisjes së mirë në vend.

Në periudhën 2003-2005, Instituti Co-PLAN i paraqiti Parlamentit të Shqipërisë një platformë për reformimin e sistemit të planifikimit dhe administrimit të territorit, duke hapur një debat dhe një cikël reformash në nivel politik që vijonë ende sot. Këto perfshijnë: decentralizimin e qeverisjes dhe financave vendore; rajonalizimin e vendit sipas praktikave të BE-së; planifikimin e territorit, formalizimin e ekonomisë, etj. Mbi bazën e kësaj përvuje dhe dëshirën e mirë për të krijuar masën kritike të ekspertëve që ecin në drejtimin e propozuar nga Co-PLAN, në vitin 2006 u themelua Universiteti POLIS. Që atëherë, të dy institucionet sinergizojnë mjaft mirë përpjekjet e tyre, duke rruajtur njëkohësisht pavarësinë e tyre. Jo rastësisht Instituti Co-PLAN tashmë ndodhet gjithashtu në kampusin e U\_POLIS dhe përfaqëson një aset me rëndësi përtë, ndërsa ky i fundit, luan rol kyç në modernizimin dhe avancimin e filozofisë së vetë Co-PLAN. Një tjetër 'rast studimor' i njohur nga shkollarë të huaj në lidhje me praktikat të zhvillimit organizativ dhe institucional.



## Co-PLAN

Co\_PLAN, Institute for Habitat Development is the origin and inspiration for the foundation of POLIS University. Co-PLAN is one of the leading NGOs in Albania and in the region and has played a key role in the alternative planning experiences which have had an all-inclusive participation. The experience of Co-PLAN was consolidated by community-based projects, namely assistance projects for the local and central government implemented in collaboration with international donors and partners, including the World Bank, UNDP, USAID, EU, FAO, ADA, SOROS, SCP, MATRA, NUFFIC etc. Co\_PLAN plays the role of a connecting bridge and contributes in the increase of capacities for efficient governing.

Between 2003-2005, Co-PLAN Institute presented a platform for the reform of the planning system and the administration of territory at the Albanian Parliament, initiating a debate and a chain of reforms which still continue today. These reforms include: decentralization of governance and local financial; regionalization of the country according to the practices of EU; territory planning, formalization of economy, etc. POLIS University was founded on the basis of this experience and the desire to create a critical mass of experts which follow the line of thought and direction proposed by Co\_PLAN. Since the university's establishment, both institutions synergize their projects while still maintaining their independence. Co-PLAN is located in the POLIS campus and represents an important asset for POLIS University while the university plays a key role in the modernization and advancement of Co\_PLAN's philosophy. Another 'case study' known by foreign scholars according to the organization and developments of the institution.

## Metro\_POLIS

"Studio Metro\_POLIS" - është një nga kolonat e praktikës profesionale të dizajnit në U\_POLIS. Metro\_POLIS është një studio alternative e arkitekturës dhe dizajnit në Shqipëri, rajon e më gjërë. Ambicia e Metro\_POLIS është që jo vetëm të jetë një byro arkitekture me reputacion, por të krijojë në menyrë originale një 'habitat intership-esh' për studentët dhe stafin akademik e kërkimor të talentuar që të praktikohen në profesion. Në këtë menyrë studioja ndërmerr punë projektuese dhe kërkimore që e ngrenë atë në nivel ndërkombëtar. Për këtë arsyet edhe Metro\_POLIS është vendosur me zyrat e saj në kampusin e Universitetit POLIS, pranë IKZH dhe Co-PLAN, duke sinergizuar në mjaft projekte të përbashkëta lokale dhe ndërkombëtare, përfshi: Shqipërinë por edhe Kosovën, Gjermaninë, Austrinë, Kroacinë, Afغانistanin, etj.

Kjo studio është një entitet privat që bashkëpunon edhe me partnerët e saj ndërkombëtarë, sidomos "3TI" dhe "Sea-Line" Itali, apo "MakeLab" Detroit USA. Universiteti POLIS, IKZH, Co-PLAN dhe Metro\_POLIS bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë e tyre. Në këtë menyrë, Metro\_POLIS përfaqëson gjithashtu një aset me rëndësi për kërkimin dhe praktikën në U\_POLIS. Tashmë ajo ka realizuar një serë objekteve konkrete, disa prej të cilave janë 'landmark' në Shqipëri.

## Metro\_POLIS

Metro\_POLIS is an alternative design studio of architecture located in the POLIS University campus along with the Institute of Research and Development\_RDI and is one of the incubators of professional practice at POLIS. Metro\_POLIS works at local, national, regional and international projects. The goal of Metro\_POLIS is not only the creation of a place where students and staff can practice their profession, but also the undertaking of research and design projects which elevate it to an international level. Metro\_POLIS and its offices are located in the POLIS campus along with RDI and CO\_PLAN, synergizing their energies in several common local and international projects, including: Albania, Kosovo, Afghanistan, Germany, Austria, Croatia, etc.


This studio is a private entity that collaborates with its international partners "3TI" Ferrara and "Sea-Line", Italy or "MakeLab" at the Polytechnic University in Detroit USA. POLIS University, RDI, Co-PLAN and Metro\_POLIS collaborate and coordinate while simultaneously preserving their own independence. Thus, Metro\_POLIS represents an important asset for research and practice at POLIS University. It has already achieved many concrete objects, some of them are 'landmark' in Albania.









## GETTING TO POLIS



## WHEN



# YOU ARE HERE



# WHEN YOU LEAVE



# Contact

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë - Durrës, km 5, Kashar  
Kodi Postar 1051, Kutia Postare 2995 Tiranë, Albania

**Tel:** + 355 42407420 /42407421;  
**Cel:** + 355 694088111 / 0694061339/ 0692374445  
**E-mail:** contact@universitetipolis.edu.al  
info@universitetipolis.edu.al

**Website:** [www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

## A MEMBER OF:

Magna Charta Universitatum  
EAAE European Association for Architecture Education  
AESOP Association of European Schools of Planning  
CEEMAN Central and East European Management Development Association  
ECLAS Association of European Schools of Landscaping  
AUA Albanian Union of Architects and Planners

15 vjet U-POLIS / 25 vjet Co-PLAN



design  
now  
14.09  
03.10

